



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
QENDRA E SHERBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2018
SESIONI I

SKEMA E VLERËSIMIT

VARIANTI A

Lënda: Sociologji

Udhëzime të përgjithshme

- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundshme të përgjigjeve të nxënësve.

Shënim: Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modelin e përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetjet me zgjedhje

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	B	A	C	A	D	D	A	C	B	D

Pyetjet me zhvillim

Pyetja 11

3 pikë

Model përgjigjeje:

- efekti hauthorne/ ndikimin e studiuesit në ndryshimin e modeleve të sjelljes së njerëzve që studiohen;
- veprimtaritë njerëzore janë të ndërlikuara/delikate, ndaj nuk mund të studiohen nëpërmjet eksperimenteve sociologjike;
- nuk përsëritet me të njëjtët njerëz në të njëjtën kohë dhe në kohë të ndryshme;
 - shembull: është absurde të provokosh luftë/konflikte/etj., për efekte studimi/çdokush do të fyhej nëse do të përfshihej në zënkë me dikë(apo arrestohej) për arsye eksperimentale;

- 3 pikë** Nëse shkruan dy kufizime dhe një shembull;
- 2 pikë** Nëse shkruan një kufizim dhe një shembull;
- 1 pikë** Nëse shkruan një kufizim; **OSE**
- 1 pikë** Nëse shkruan një shembull;
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12**3 pikë**

Model përgjigjeje:

- të rinjtë janë më të prirur të formojnë grupe kundërkulturore;
- përpjekje e të rinjve për të provuar një jetë tjetër, rrënjësisht të ndryshme nga ajo e traditës; “hipitë” amerikane kundër vlerave individualiste/konkurruese/materialiste, kishin prirje altruiste, vlerësonin sinqeritetin (shpirtdëlirësinë) më shumë se pasurinë/braktisën shtresat e mesme dhe të larta të shoqërisë;
- zhvillojnë folkuej të tyre të veçantë;
- mënyra të veçanta të veshjes, (xhinse, kur ishin simbol i punëve të rëndomta), etika e sjelljes, dëfrimit, shijet artistike muzikore;
- më pak të ndikuar nga opinioni, etj.

3 pikë	Nëse shkruan dy prirje dhe një shembull;	OSE
2 pikë	Nëse shkruan dy prirje;	OSE
2 pikë	Nëse shkruan një prirje dhe një shembull;	
1 pikë	Nëse shkruan saktë vetëm një prirje;	OSE
1 pikë	Nëse shkruan saktë vetëm një shembull;	
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.	

Pyetja 13**3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Njerëzit duan dhe aftësohen për njohjen e ideve të njëri- tjetrit. Kjo ndodh kur ata përpiqen të njohin qëllimet e të tjerëve. Secili kupton se një person tjetër mund të reagojë ndaj tij, duke imagjinuar veten në rolin e tjetrit.
- Duke përdorur simbolet në ndërveprimin shoqëror, njerëzit përgjithësisht e shohin veten sikurse të tjerët i shohin ata. Mid e quan këtë “marrje e rolit të tjetrit”, “vënie në rolin e tjetrit”.
- Kulej e krahason shoqërinë me në pasqyrë, në të cilën ne jemi të aftë të përfytyrojmë veten sipas asaj se si të tjerët kundërpërgjigjen ndaj nesh. Ai përdorte shprehjen “pasqyrë e vetes”, duke kuptuar veten si të përcaktuar nga reagimet e të tjerëve. Të tjerët shërbejnë si pasqyrë ku çdo individ sheh veten të vendosur në role të të tjerëve. Kjo ndodh në procesin ndërveprimit shoqëror.
- Kulej dhe Mid shprehen se aftësia për të marrë role të të tjerëve bazohet në përdorimin e simboleve dhe është themeli i vetes shoqërore dhe i përvojës shoqërore të çdo individi.

3 pikë	Nëse shkruan tre faktorë ;
2 pikë	Nëse shkruan dy faktorë;
1 pikë	Nëse shkruan një faktor;
0 pikë	Nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14**4 pikë**

Model përgjigjeje:

- a) Kuptimi relativ i sjelljeve deviante ose jo, ka limite. Ata janë herë të dukshëm e herë të padukshëm. Sjelljet deviante ndikojnë në qartësimin e këtyre kufijve.
-shembull: lejimi me një masë të caktuar i pijeve alkoolike në lokal. Kur kalohet masa e përdorimit të tij, sjellja e individit bëhet deviante, duke shqetësuar të tjerët, të cilët kundërshtojnë në mënyra të ndryshme. Këto sjellje kundërshtuese u mësojnë anëtarëve të shoqërisë kufijtë e të moralshmes dhe të pamoralshmes në një kohë të caktuar.
- b) Shumica përjetojnë ndjenja zemërate (njerëzit e vetëdijshëm të shoqërisë) për sjelljet deviante, sidomos ato të rënda duke u bërë gjithnjë e më të vetëdijshëm për normat dhe vlerat kulturore që i bashkojnë.

-shembull: Në shoqëritë me popullsi të përzier, për sjelljet deviate të njerëzve nga e njëjta kombësi emigrantët bashkohen për të përballur së bashku vështirësitë e jetës në vend të huaj. Rilindësit shqiptarë reagonin ndaj çdo veprimi të politikanëve që shmangej sadopak nga interesi i Lëvizjes Kombëtare, duke forcuar unitetin e të gjithë shqiptarëve.

- 4 pikë** Nëse shkruan nga një tipar dhe nga shembull për secilin funksion;
3 pikë Nëse shkruan nga një tipar për secilin funksion dhe një shembull për tjetrin **OSE** nëse shkruan nga një shembull për secilin funksion dhe një tipar për tjetrin;
2 pikë Nëse shkruan nga një tipar për secilin funksion **OSE** nëse shkruan nga një shembull për secilin funksion;
1 pikë Nëse shkruan një tipar për njërin funksion **OSE** nëse shkruan një shembull për njërin funksion;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15 **3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Deri para Luftës së Dytë Botërore ishte e lejuar.
- Ndodhte zakonisht në burrat e pasur.
- Nuk pritej mirë nga shumica e shoqërisë.
- Justifikohej me dëshirën për lindjen e shumë fëmijëve, sidomos djem./kjo sidomos në shoqëritë fshatare).
- Çdo familje matej e mbrohej me numrin e meshkujve.
- Në këtë “klime” psikokulturore, gruaja që nuk lindte fëmijë, ishte e detyruar të divorcohej ose të pranonte gruan e dytë të burrit të saj./ Zakonisht kjo ndodhte, jo divorci.
- Më pas, gruaja e parë fitonte një status tjetër më të nderuar në familjen e burrit.
- Çlirohej nga disa punë të rëndomta, administronte punët e shtëpisë dhe edukimin e fëmijëve etj.

- 3 pikë** Nëse shkruan tre aspekte;
2 pikë Nëse shkruan dy aspekte;
OSE
1 pikë Nëse shkruan një aspekt;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 **4 pikë**

Model përgjigjeje:

- a)
- marrëdhëniet ndërmjet shtetit të shumicës së popullsisë dhe shtetit “amë” të pakicave kombëtare ose grupeve etnike.
 - Këto marrëdhënie janë më vepruese, sidomos kur shtete të tilla, përgjithësisht të ndërlikuar, veprojnë në dy kahe. Nga njëra anë, ato veprojnë në marrëdhëniet ndërmjet shumicës dhe pakicave kombëtare ose etnike. Nga ana tjetër, mënyra e trajtimit të pakicave përcakton, në një masë të ndjeshme, marrëdhëniet ndërmjet shteteve të tilla. Shkalla dhe kahu i këtyre ndikimeve ndryshojnë dukshëm kohë pas kohe.
- b)
- veçoritë e formimit psikokulturore të popullsisë që përbën shumicën etnike. Përgjithësisht, formimi psikokulturore i popujve ndryshon me ngadalësi. Ndaj, një faktor i tillë është ndoshta kryesor për ecurinë e marrëdhënieve ndërmjet grupimeve etnike në shumicë dhe pakicë.

- 4 pikë** Nëse shpjegon nga dy elemente të secilit faktor;
3 pikë Nëse shpjegon një element nga njëri faktor dhe dy elemente nga tjetri;
2 pikë Nëse shpjegon një element nga njëri faktor dhe një element nga tjetri;
1 pikë Nëse shpjegon një element vetëm nga njëri faktor;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

Pyetja 17**2 pikë**

Në Shqipëri procesi i shekullarizimit ka përshkruar të gjitha organizatat fetare, sidomos pas shpalljes së Pavarësisë. Regjimi i Ahmet Zogut i nxiti prirjet shekullarizuese si rrjedhojë e bashkërendimit të dy pikësynimeve kryesore:

- masivizimi i vrullshëm i arsimit, përmirësimi i shpejtë i nivelit arsimor të masave popullore, rritja e numrit të specialistëve me arsim të lartë në strukturën e popullsisë. Nga përvoja e vendeve të Perëndimit, zhvillime të tilla nxitin proceset shekullarizuese.
- masat e shumanshme e të përshkallëzuara të partisë-shtet e të organizatave të masave për të çrënjësuar besimet fetare, për të krijuar një shoqëri ateiste. Në vitin 1967 në Shqipëri u ndalua edhe nga organet shtetërore ushtrimi i besimeve dhe i praktikave fetare. Rrethana të tilla deri në vitin 1990 domosdoshmërisht diktuan te shqiptarët, sidomos te rinia, një lloj “ateizmi” të detyruar.

Nxënësi fiton:

- 2 pikë** Nëse shkruan dy prirje;
1 pikë Nëse shkruan një prirje;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18**3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Shumica e veprimtarive ekonomike regjistrohen dhe taten nga organet shtetërore përkatëse. Krahas këtyre, funksionon edhe ekonomia e paligjshme, e cila përfshin të gjitha veprimtaritë ekonomike që sigurojnë të ardhura, por që nuk janë të regjistruara në organet shtetërore të taksimit.
- Veprimtaritë ekonomike joligjore janë të shumta: shitja e lëngjeve/ paketa cigaresh/ banane, etj., nga fëmijët para shtëpisë /deri te puna e pataksuar jashtë orarit e mjekut, e marangozit, rrobaqepësit, etj./ Të padeklaruara janë edhe të ardhurat nga bakshishi që marrin kamerierët ose ryshfeti që marrin nëpunësit, të ardhura nga vjedhja / tregtia e lëndëve narkotike, etj.
- Është e vështirë të përcaktohen “përmasat” e ekonomisë jo ligjore. Në ShBA llogaritej gati 10% e gjithë veprimtarisë së paligjshme në fund të shek. XX dhe në fillim të shekullit XXI.
- Për vendet që janë në periudhën kalimtare, siç është vendi ynë, pesha specifike e ekonomisë joligjore është përgjithësisht e lartë.
- Një nga shkaqet e kësaj gjendjeje është edhe prirja e shumë njerëzve për t’u pasuruar shpejt nëpërmjet rrugëve të kundërligjshme, nga mungesa e përvojës së organeve shtetërore për kontrollimin dhe taksimin e veprimtarive të ndryshme ekonomike, etj.

- 3 pikë** Nëse shkruan tre tipare;
2 pikë Nëse shkruan dy tipare;
1 pikë Nëse shkruan një tipar;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19**3 pikë**

Model përgjigjeje:

- Pas suksesit në plotësimin e qëllimeve të saj, ajo nuk ka arsye të vazhdojë.
- Mund të dështojë nga udhëheqja e paaftë e saj/nga përçarja dhe konfliktimi i pjesëmarrësve në të, si pasojë e ndryshimit të interesimit të tyre për lëvizjen në rrjedhën e zhvillimit të saj
- Nëse udhëheqësit korruptohen nga organet shtetërore në fuqi, të cilat mund t’u ofrojnë atyre shpërblime (para, poste, etj). Këta udhëheqës sigurojnë përfitime të shumanshme, kur braktisin qëllimet kryesore të lëvizjes.
- Trysnia e masave kufizuese dhe të dhunës që mund të ushtrojnë ndaj tyre organet shtetërore, të cilat mbrojnë interesat e klasës në fuqi. (Një pjesë humbin vrullin kundërshtues ndaj sistemit shoqëror në fuqi pasi plotësojnë një pjesë të kërkesave të rëndësishme.)

- 3 pikë** Nëse shkruan tre arsye;
2 pikë Nëse shkruan dy arsye;
1 pikë Nëse shkruan një arsye;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20**2 pikë**

Model përgjigjeje:

- Modernizmi u premtoi njerëzve një jetë të çliruar nga mungesat.
- Shekulli i XX konsiderohet i pasuksesshëm në përpjekjet për zgjidhjen e problemeve shoqërore, si varfëria për një numër të madh njerëzish, mungesa e sigurimit financiar për shumë të tjerë, etj.
- shembull: Nga ana tjetër, ka vlerësim pozitiv për mosdështim të plotë të modernitetit. Në vende si SHBA dhe të tjerë me industri të zhvilluar, ka rritje të ndjeshme të nivelit të jetesës dhe jetëgjatësisë mesatare.

2 pikë

Nëse shkruan një argument për dështim dhe një shembull për të kundërtën;

1 pikëNëse shkruan një argument për dështim **OSE** nëse shkruan një shembull për të kundërtën;**0 pikë**Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.